

Data 10.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “SHTIM KATI DHE RIKONSTRUKSION I IML-SË DHE MORGUT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 56, 629,136 (Pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtë qindë e njëzetë e nëntë mijë e një qindë e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, specialisti i fushës së njësisë së prokurimit të ngritur me urdhër **nr.7413, datë 31.08.2023** “Për ngritjen e Njësisë së Prokurimit për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Shtim kati dhe rikonstruksion i IML-së dhe Morgut” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2. Vërtetimi i xhiros vjetore nga administrata tatimore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: 56,629,136.53 (pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtë qindë e njëzetë e nëntë mijë e një qindë e tridhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 28,314,568.2 (njëzetë e tetë milion e tre qindë e katërbëdhjetë mijë e pesë qindë e gjashtëdhjetë e tetë pikë dy) lekë pa TVSH, të realizuar **gjatë tre viteve të fundit**.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku **gjatë tre viteve të fundit** është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 113,258,273 (njëqind e e trembëdhjetë milion e dy qindë e pesëdhjetë e tetë mijë e dy qindë e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshme/përfundimtar;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshme/përfundimtar;
2. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomik si dhe prokuren e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë;

Mbështetur në rëndësinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të vënë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndërtimit etj.

3. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P-1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P-2 C Ndërtime civile dhe industriale;
- N.P-3 B Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile, industriale veshje fasadash;
- *N.P-7 A Ujësjiellësa, gazësjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje;*

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- N.S-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S-3 A Impiante ngritëse dhe transportuese, ashensor shkalle lëvizëse transportuese;
- N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- *N.S-8 A Ndërtime parafabrikat beton të armuar, struktura metalike dhe druri;*
- N.S-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- *N.S-13 A Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni;*
- N.S-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;
- N.S-18 A Punime topogjeodezike;

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikën 1 të nenit 8 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe në VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar.

Ky kriter është vendosur me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e punimeve objekt prokurimi, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve.

4. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licencë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullimi, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesat e sipërcituara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 2 ku citohet se: *“Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”*, si dhe në zbatim të nenit 39, pika 6/a/b të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose”. Ndërsa përcaktimi i llojit të licencave nga ofertuesi, referuar natyrës së kontratës, bazohet në ligjin 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

5. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 6 (gjashtë) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - a) Librezë pune;
 - b) Kontratë pune e vlefshme;
 - c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, (pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të dy kriterëve të sipërcituara lidhur me stafin inxhinierik dhe drejtuesin teknik të punimeve, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës dhe mban përgjegjësi teknike dhe drejtuese për zbatimin e kontratës në mënyrë cilësore. Për këtë qëllim, referuar edhe vlerës së kontratës për Shtimin e katit dhe rikonstruksionit të IML-së dhe morgut, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që drejtuesi teknik të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Por në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, AK ka qartësuar se ky detyrim duhet të përmbushet vetëm kur plotësohen kushtet ligjore. Pra në rastin e bashkimit të subjekteve, drejtuesi teknik duhet të jetë i angazhuar gjatë gjithë kohës, vetëm nëse vlera e preventivuar e punimeve e marrë përsipër nga anëtarë i bashkimit është mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Gjithashtu kontraktori duhet të deklarojë se drejtuesi teknik i përfshirë në licencën e shoqërisë nuk duhet të jetë i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publik, në zbatim të Kreut IV, pika 2 të VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 45 punonjës të vërtetuar me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

7. Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve objekt kontrate, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Arkitekt	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi profili strukture	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projekt-preventivin, dhe specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierin ndërtimit dhe elektroteknik në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe çdo profil i kërkuar për inxhinieret e sipërcituar, është përcaktuar mbi bazën e analizës teknike që i është bërë preventivit, nisur nga tipologjia dhe sipas llojit apo rëndësisë së objektit që kërkohet nga ky prokurim, duke u nisur edhe nga kërkesat funksionale të tij, apo natyrës së veçantë që ky objekt arsimor përfaqëson mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Pra, rezulton se është e domosdoshme që çdo OE të ketë pjesë të stafit Inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbeshtetes, si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Inxhinieret e kerkuar janë në perputhje me licencat e kerkuara.

Stafi i mesiperm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve. Konkretisht:

- Arkitekt -
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi- Ne preventiv parashikohen punime germimi, punime rikonstruksioni ndërtese;
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili strukturor- Ne preventiv parashikohen punime germimi, punime rikonstruksioni ndërtese;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik- Ne preventiv parashikohen punime per sisteme hidrosanitare
- 1 (një) Inxhinier Elektrik- Ne preventiv parashikohen punime per rikonstruksion te rrjetit elektrik te nderteses
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet – Ne preventiv prarashikon punime për të cilat është e nevojshme për të studiuar bazamentin
- 1 (një) Inxhinier Mekanik- Ne preventiv prarashikon punime për të cilat është e nevojshme për punime e termodinamikës, kondicionim etj.

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi- Ne preventiv prarashikon punime për të cilat është e nevojshme për punime e termodinamikës, kondicionim etj.

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

8. Një specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, vërtetuar me kontratë individuale pune të vlefshme , diplomë/certifikatë, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimum për tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin).*
9. 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*

Argumentimi: Kërkesa për punonjës të kualifikuar dhe të specializuar është bërë referuar VKM nr.627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, si dhe në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, si dhe në pikën 4, të nenit 49, të Ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, kështu; Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjesi i cili duhet te jetë i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe 1(një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH, shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e tyre, të cilët nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangi apo parandaloje çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtyre kriterëve shërben si një garanci që OE do të realizojë punimet në kantierin e hapur të punës.

Janë kërkuar specialistë ndihmës për të gjitha proceset e punës, në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre, specialistë këto të çertifikuar sipas legjislacionit të formimit profesional. Po kështu, meqenëse ky objekt është rikonstruksion dhe ndodhet ne nje pjese shume te rendesishme te kryeqytetit, te mbipopulluar dhe me shume levizje eshte kerkuar qe te gjithë specialistet te kene nje eksperience te konsoliduar ne profesionin e tyre, gje qe do te krijojë mundesine per punime sa me cilesore, pa vene ne rrezik objekteve fqinje, apo të të sëmurëve pranë spitaleve që janë përreht objektit që do të ndërtohet.

Çertifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse të njohur nga Republika e Shqipërisë, si psh nga Ministria e Financave dhe/ose Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, mbështetur në Ligjin nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e shqipërisë” apo në ligjin e mëparshëm nr.8872, datë 29.3.2002. Mbështetur në këtë legjislacion çertifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Çertifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-së. Po kështu theksojmë se janë të pranueshme edhe diplomat apo certifikatat e lëshuara sipas legjislacionit përkatës përpara datës 29.3.2002.

Kërkesa për një Mjek mbështetet në Vendimin Nr.632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” si dhe në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, ku përcaktohet se: “.....marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.”

AK domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me një eksperiencë të mjaftueshme për zbatimin e këtyre shërbimeve me standarte dhe cilësi, pasi nuk mund të pranohet që punimet të kryhen nga punonjës të paspecializuar dhe pa eksperiencën e detyrimit ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

10. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi
- 3 (tre) punonjës elektrikist
- 2 (dy) punonjës hidraulik
- 3 (tre) punonjës hekurthyes
- 2 (dy) punonjës hidroizolues
- 2 (dy) punonjës murator
- 2 (dy) punonjës karpenier
- 3 (tre) punonjës saldator
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 1 (një) punonjës mekanik
- 1 (një) punonjës IT
- 3 (tre) punonjës eskavatorist
- 3 (tre) punonjës automakinist

- 6 (gjashtë) shoferë
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë për Auditues Energjetik në ndërtesa dhe instalime industrial
- 2 (dy) punonjës pajisur me certifikatë për punime në lartësi

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. kontratën individuale të punës te vlefshme;
- b. diplomë/ certifikatë që vërteton kualifikimin profesional të mësipërm;
- c. Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e sipërcituar emrin, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse si dhe institucionin që e ka lëshuar këtë dokument.

Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjesit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Vendosja e kërkesave të mësipërme është bërë për të vërtetuar kapacitetin teknik të OE, i cili duhet të disponojnë një staf të mjaftueshëm jo më pak se 25 punonjës, për të përmbushur me sukses dhe

në kohë kontratën, si dhe mbështetur në preventivin, volumet e punës, afatin, specifikimeve, zërat e punës, të cilët duhet të angazhohen në objekt, përjashtimisht punonjësve të tjerë nëse OE mund të kenë kontrata të tjera në vazhdim. OE duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*). Bazuar në kater elementet e struktures se kostos (*material, puntori, makineri, transport*). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr.8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Stafi i mesiperm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve. Konkretisht:

- 2 (dy) punonjës teknik ndertimi- Per te kontrolluar punen ndertimore dhe per te dhene udhezime te ndryshme per punimet
- 3 (tre) punonjës elektrikist - për punimet e instalimeve elektrike të preventivit
- 2 (dy) punonjës hidraulik - për punimet hidrosanitare të preventivit
- 3 (tre) hekurthyes- i nevojshëm gjatë punimeve sipas preventivit
- 2 (dy) punonjës hidroizolues- punime izolimi catie dhe punime hidroizolimi
- 2 (dy) punonjës murator- punime mutarure, punime betoni
- 2 (dy) punonjës karpenier- per punimete armaturave
- 3 (tre) punonjës saldator- per shkall emergjence
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues- punime shtresa, shtresa dhe veshje
- 1 (një) punonjës mekanik- i nevojshëm gjatë punimeve
- 1 (një) punonjës IT- i nevojshëm gjatë punimeve sipas preventivit
- 3 (tre) punonjës eskavatorist- për drejtimin e mjeteve: Eskavator, autovinc, fadrome sipas rendit të puneve
- 3 (tre) punonjës automakinist- për drejtimin e mjeteve kamion, kamioncina, autobot etj, sipas rendit të puneve.
- 2 (dy) punonjës pajisur me certifikatë për punime në lartësi- të nevojshëm për shtimin e katit, pasi do të jetë mbi katin e dytë të godinës ekzistuese të IML-së.

11. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj. (*Ky dokument duhet të paraqitet në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit në SPE*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikën 1 të nenit 8 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” të ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, për të vërtetuar dhe garantuar AK për realizimin e punimeve në kohë dhe me sukses.

12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 8 (tetë) muaj kalendarike.

Argumentimi: Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

13. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementët e tjerë që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.
- PLANIN E SIGURISË NË KANTIER për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 datë 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikën 1 të nenit 8 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe të VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 datë 06.11.2003”, për të vërtetuar dhe garantuar sigurimin e punonësorëve si dhe personelin përreth, duke qënë se gjatë kohës që do të kryhen punimet në katin e parë dhe të dytë ka punonjës si dhe në ambientet e morgut.

14. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet: **elektrike, tuba dhe hidrosanitare** sipas zërave të preventivit. Për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë

teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

15. Operatorik ekonomik ofertues duhet të paraqesë analizën e çmimeve të preventivit të ofertuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin prova të zberthimit të rregullt të preventivit dhe që e bazojnë ofertën e tyre mbi bazën e një analize të sakte të shpenzimeve dhe fitimeve për punën objekt kontrate.

Disa nga zerat e preventivit nuk parashikohen në manualin e çmimeve dhe analizave teknike kështu që operatorët duhet të deshmojnë menyrën se si i ofertojnë keto zera .

16. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).
- b. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Për shkak të natyrës së veçantë, rëndësisë dhe volumit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë një sistem të menaxhimit të cilësisë dhe janë të aftë për të ofruar materiale që plotësojnë kërkesat e AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për

njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

17. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi	Pershtatshmeria me preventivin (Justifikimi)
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	copë	4	Në pronësi ose me qera	Punime germimi dhe prishje
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 ton deri 20 ton	copë	4	Në pronësi ose me qera	Punime germimi dhe prishje
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime germimi dhe prishje
4	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime te ndryshme dhe prishje
5	Eskavator me zinxhirë	copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime dheu, germime
6	Eskavator me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime dheu, germime
7	Fadromë me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime germimi
8	Minieskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime dheu , germime
9	Autobetoniere	copë	3	Në pronësi ose me qera	Punime betoni
10	Autopompë betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime me beton
11	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera	Transport hekur materiale te ndryshme
12	Autobot uji	copë	2	Në pronësi ose me qera	Për të bërë llac, per lagie
13	Skeleri fasade	m2	2000	Në pronësi ose me qera	Mbrojtese për sigurinë
14	Popmë suvatimi	copë	3	Në pronësi ose me qera	Per suvatime
15	Gjenerator	copë	3	Në pronësi ose me qera	Per venien ne pune te pajisjeve ne pamundesi per te marre rryme elektrike nga objekti
16	Elektrosaldatrice	copë	3	Në pronësi ose me qera	Shkalle emergjence,ashendsor
17	Moto gjenerator	copë	2	Në pronësi ose me qera	Per venien ne pune te pajisjeve ne pamundesi per te marre rryme elektrike nga objekti

18	Depozite uji 5000 litra	copë	4	Në pronësi ose me qera	Për të bërë llac, per lagie
19	Matrapik	copë	3	Në pronësi ose me qera	Prishje, thyerje
20	Vibrator thellësie betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera	betonime
21	Betoniere kantieri	copë	5	Në pronësi ose me qera	Per beton
22	Kokore	copë	45	Në pronësi ose me qera	Per sigurine ne pune te punetoreve
23	Rripa sigurimi	copë	10	Në pronësi ose me qera	Per sigurine ne pune te punetoreve
24	Jelek	copë	45	Në pronësi ose me qera	Per sigurine ne pune te punetoreve
25	Komplete të ndihmës shpejtë	copë	20	Në pronësi ose me qera	Per sigurine ne pune te punetoreve
26	Prozhektor për ndricim	copë	3	Në pronësi ose me qera	Per te ndricuar terrenin
27	Tranxhe për përpunimin e hekurit të ndërtimit	copë	1	Në pronësi ose me qera	Për përpunimin e hekurit
28	Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë)	copë	1	Në pronësi ose me qera	zyrë për personelin teknik
29	Elektrobango	copë	1	Në pronësi ose me qera	Vegla pune për hekur

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi (te shenohet ne LQ qe eshte perdorimi per te trete); ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash per te trete brenda vendit (e vlefshme).

c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto

të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi për ndërtimet, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të objektit dhe projekteve përkatëse të zbatimit (projektin e punimeve ndërtimore, projektin e punimeve elektrike dhe projektin e punimeve hidrosanitare) me qëllim përshkrimin e cilësisë të të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesave të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

Fondi limit për këtë procedurë është përlogaritur në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 629 date 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, duke u bazuar në volumet e punimeve të parashikuara në projektin dhe preventivin bashkëngjitur.